

Vijojnë konvertimet e maqedonasve në Islam, ku më së shumti bien në sy femrat. Më i fundi rast është ai në Strugë, ku Ratka Belkoska, qytetare e atyshme, ka kaluar në Islam duke dëshmuar atë që konsiderohet kredoja e besimit, shehadetin.

Ky akti pasoi dhe me kurorëzimin saj në martesë. Ishte myftiu i Strugës, Salim efendi Sylejmani, që drejtoi ceremoninë e martesës së saj me Demir Balltiq.

“Që nga dita e sodit, unë jam pjesëtare e fesë islame, domethënë myslimane, e martuar me vetëdëshirë me Demir Balltiqin nga Moroishta e Strugës. Ndjem shumë krenare për faktin që Zoti Fuqplotë më udhëzoi që ta pranoj Islamin për fe timen”, ka deklaruar në mes tjerash, zonja Balltiq.

Muaj më parë, tesheshi.com informoi edhe për rastin e konvertimit në Islam të maqedonases Katerina Zaova nga qyteti i Prilepit, e cila pati presione të shumta nga shoqëria dhe familja, derisa u martua me boshnjakun Jasmin Fetahović./tesheshi/